

V E N D I M
Nr.11, datë 19.9.1995

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar	i “““
Manol Konomi,	Anëtar	i “““
Zija Vuci,	Anëtar	i “““
Franc Jakova,	Anëtar	i “““
Metush Saraçi,	Anëtar	i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar	i “““

me sekretare Drita Filto, më datat 18.9.1995 dhe 19.9.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S : 1. KËSHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga Ministri i Drejtësisë, Hektor Frashëri.

PERSONA TË INTERESUAR : 1. PROKURORI I PËRGJITHSHËM i REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Alush Dragoshi.

2. FATOS NANO, i përfaqësuar nga avokati Përparim Sanxhaku.

O B J E K T I:

Deklarimin antikushtetues të mbledhjes së Plenumit të Gjykatës së Kasacionit dhe shqyrtimit prej tij të kërkesave për mbrojtje të ligshmërisë në lëndë penale.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Në datën 26 korrik 1995, bazuar në Kodin e Procedurës Penale të miratuar me ligjin nr.6069 datë 25.12.1979 (i cili ishte në fuqi deri në 31 korrik 1995) është mbledhur Plenumi i Gjykatës së Kasacionit për shqyrtimin e tre kërkesave për mbrojtje të ligshmërisë në lëndë penale. Ndërsa njërien prej kërkesave Plenumi e ka shqyrtuar dhe e ka pranuar, për dy të tjerat, e konkretisht për atë që i përkiste çështjes penale në ngarkim të të dënuarit Fatos Nano si dhe atë që i përkiste të dënuarit B.K., për shkaqe të ndryshme nuk i ka shqyrtuar duke vendosur shqyrtimin e tyre në muajin shtator 1995.

Ky Vendim i Plenumit të Gjykatës së Kasacionit i datës 26 korrik 1995 , për shqyrtimin e çështjeve në shtator, është antiligjor e antikushtetues.

Me ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 Kuvendi Popullor ka miratuar Kodin e Ri të Procedurës Penale, i cili është shpallur nga presidenti i Republikës me dekretin nr.1059, datë 5.4.1995 dhe ka hyrë në fuqi në datën 1 gusht 1995.

Kodi i ri i Procedurës Penale, ndryshe nga Kodi i mëparshëm, nuk parashikon kërkesën për mbrojtje të ligshmërisë si mjet të jashtëzakonshëm në kompetencën ekskluzive të kryetarit të Gjykatës së Kasacionit e të Prokurorit të Përgjithshëm dhe as Plenumin e Gjykatës së Kasacionit si hallkën më të lartë gjyqësore në lëndë penale.

Kodi i ri nuk përmban dispozita tranzitore lidhur me çështjet penale që ndodheshin në hetim apo gjykim në kohën e hyrjes së tij në fuqi e për pasojë nga 1 gushti i vitit 1995 do të zbatohet Kodi i ri i Procedurës Penale. Me ligjin nr.7977, datë 26.7.1995, i cili hyri në fuqi në 1 gusht 1995, Kodit të ri të Procedurës Penale, në nenin 525 ju shtua një paragraf i ri sipas të cilit “Për çështjet penale që ditën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi ndodhen në fazën e hetimit ose të gjyqimit në shkallë të parë dhe në apel, do të zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të mëparshëm,por jo më pas se 15 nëntor 1995”.

Është parim i njohur e i pranuar se ndryshe nga e drejta penale materiale ku zbatohet parimi se ligji i ri nuk ka fuqi prapavepruese, me përjashtim të rasteve kur ai është në favor të të pandehurit, në të drejtën procedurale penale vepron parimi sipas të cilit ligji i ri ka fuqi edhe ndaj marrëdhënieve procedurale të lindura para hyrjes së tij në fuqi, për çështje që gjenden në hetim apo gjykim, me përjashtim të rasteve e për një kohë kur vetë ligji shprehimisht ka vendosur.

Edhe nga përmbajtja e ligjit nr.7977, datë 26.7.1995 del qartë zbatimi i parimit të lartpërmendur të prapaveprueshmërisë të ligjit procedural penal si dhe vullneti i legjislatorit mbi suprimimin e Plenumit të Gjykatës së Kasacionit në lëndë penale dhe të institutit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Këtë parim ka zbatuar Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.3, datë 14.2.1994.

Në këto kushte Plenumi nuk legjitimohej të vendoste vazhdimësinë e ekzistencës së tij pas datës 31 korrik 1995 e as vlefshmërinë e mjeteve të jashtëzakonshme për atakimin e vendimeve, në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjin nr.7977, datë 26.7.1995. Në këtë mënyrë janë shkelur dy dispozita kushtetuese, e konkretisht : nenin 5 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, në paragrafin e fundit të të cilit sanksionohet se: “Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat që janë të pavarura dhe udhëhiqen nga ligji” si dhe nenin 5 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” paragrafi i fundit i të cilit shprehet se: “Organizimi dhe kompetencat e gjykatave rregullohen me ligj”.

Përfaqësuesi i personit të interesuar F. Nano, gjatë seancës gjyqësore pretendoi se pranimi i parimit të prapaveprueshmërisë së Kodit të ri të Procedurës Penale, prek të drejtat kushtetuese, të parashikuara nga neni 6 i ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për një shtojcë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Në referim të dispozitës së mësipërme, të drejtat e sanksionuara në nenin 6 (mosdënim pa ligj) që pretendohen se janë shkelur lidhen shprehimisht me ligjin penal material dhe jo me atë procedural. Një përfundim i tillë del edhe nga dokumentat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të pranuar nga vendi ynë.

Po kështu ky përfaqësues pretendoi se edhe pse shtesa që iu bë Kodit të Procedurës Penale me ligjin nr.7977, datë 26.7.1995 nuk është antikushtetuese, ajo ka çënuar të drejtat e të mbrojturit prej tij.

Ky pretendim është i pabazuar sepse nxjerrja e këtij ligji nuk ka asnjë lidhje me ekzistencën e Plenumit të Gjykatës së Kasacionit dhe kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Miratimi i shtesës në fjalë nuk rëndoi aspak të dënuarin Fatos Nano, qoftë edhe të dënuarin B.K., pasi vetë Kodi i ri i Procedurës Penale ka suprimuar Plenumin e Gjykatës së Kasacionit dhe të drejtën për kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë në çështjet penale.

Gjykata e çmon të pabazuar pretendimin se me suprimimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të Plenumit të Gjykatës së Kasacionit, mohohet e drejta kushtetuese e ankimit ndaj vendimit gjyqësor, sanksionuar nga neni 13 i ligjit “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të njeriut”. Sipas këtij neni asnjë vendim gjyqësor nuk mund të jepet pa i garantuar qytetarit të drejtën e apelimit. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ka qenë një mjet i jashtëzakonshëm i goditjes së vendimeve të formës së prerë që kanë kaluar të gjitha shkallët e gjykimit dhe që varej në diskrecionin e Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit e të Prokurorit të Përgjithshëm. Kodi i ri i Procedurës Penale ka rivendosur mënyrën e atakimit të vendimeve të formës së prerë me anën e institutit të rishikimit.

Së fundi, përfaqësuesi i personit të interesuar ngriti pretendimin se Këshilli i Ministrave nuk legjitimohet të ngrerë këtë lloj kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

Duke iu referuar përmbajtjes së neneve 36 pika 5 të ligjit nr.7491, datë 19.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” si dhe të nenit 25 të ligjit nr.7561, datë 19.4.1992, Gjykata Kushtetuese e gjen me vend legjitimimin e Këshillit të Ministrave.

Duke u bazuar në shqyrtimin në tërësi të çështjes, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se mbledhja e Plenumit të Gjykatës së Kasacionit në lëndë penale nga data 1 gusht 1995 është antikushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24, pika 3 dhe nenit 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1991 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin si antikushtetues të Vendimit të Plenumit të Gjykatës së Kasacionit, datë 26 korrik 1995 për shqyrtimin pas datës 31 korrik 1995 të kërkesave për mbrojtje ligjshmërie të çështjeve penale.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot më 19.9.1995